



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOFIKA K. BRAKA
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.11, NR.1, NR.1
TEL: 684066835

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 1357

Nr. koleksioni: 798

Tirane më 16/09/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2022052850081686777



A202205285008168677

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE, TIRANË
NR. 1357 REP.
NR. 798 KOL.



AKTI I THEMELIT
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GREAT VIEW HOSPITALITY” SH.P.K.

Sot me date 16 Shtator 2022, para meje Noterit Publik **Sofika K. BRAKA**, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me sei në: Rr. Ismail Qemali, Nd. 11/1, Shk.1, Ap.1, Tiranë u paraqit personalisht:

Themeluesi që nënshkruan më poshtë:

- **Z. Mirsad ZYMERI**, shtetas i Kosovës, i biri i Shefqet dhe i Drita, lindur me 08 Gusht 1984, në Bakshi, Kosovë dhe banues në Prishtinë, Kosovë, mbajtës i Pasaportës me Nr. P02118466 dhe Nr. Personal 1500995226.

Që në vijim do të quhet **Ortaku**,

I cili me vullnetin e tij të lirë, bazuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,

Vendos të themelojë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në bazë të kushteve që vijojnë:

KREU I
OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

1.1. Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie:

(a) Blerje-Shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme (prona te ndryshme, si troje, toka bujqësore, apartamente banimi, ambiente shërbimi dhe tregtimi etj., pasuri këto ne pronësi te shoqërisë ose ne pronësi te shoqërive te tjera, personave fizike apo juridike, te cilët e autorizojnë për përfaqësim shoqërinë, për blerje-shitje.

(b) Qiradhënia dhe marrja me qira e objekteve të luajtshme dhe të paluajtshme me qëllim realizimin e fitimit të shoqërisë;



A2022052850081686777

- (c) Zhvillimit të projekteve të ndryshme ndërtimore;
- (ç) Investimi, zbatimi, zhvillimi, menaxhimi i zonave civile, industriale, turistike, si edhe shërbimeve të tjera të veprimtarive tregtare të ngjashme ose të lidhura me to.
- (d) Kryerja e veprimtarive tregtare në fushën e ndërtimit, për prodhim dhe shitblerje të materialeve të ndërtimit.
- (dh) Kryerja e aktivitetit për investimin në fushën e ndërtimit, në komplekse civile, turistike, industriale, sociale, komplekseve të tregtimit dhe të shërbimit bar-restorant-hoteleri etj.
- (e) Pjesëmarrje në projekte ndërtimore dhe turistike, si sipërmarrës, investitor, konsulent, si dhe marrjen për sipër të menaxhimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- (ë) Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale apo rielizimin e projekteve turistike.
- (f) Përfaqësimi i palëve të treta në transaksionet e shitblerjes së pasurive të paluajtshme;
- (g) Përfaqësimi i palëve të treta në territorin e Republikës së Shqipërisë për realizimin e investimit e huaja dhe vendase në sektorin e turizmit apo sektorë të tjerë të ndryshëm të ekonomisë;
- (h) Çdo aktivitet tjetër ekonomik të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

2.1. Emërtimi i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar është: "GREAT VIEW HOSPITALITY" sh.p.k.

2.2. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rr. Ismail Qemali, Nd. 11/1, Shk. 1, Ap. 1, Tiranë

2.3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Regjimi juridik

3.1. Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

3.2. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të ndryshohet regjimi juridik i Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast do të përshtaten dhe aktet themelore të shoqërisë.



3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

3.4. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II
TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

Neni 4
Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak/aksioner në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

4.5. Ortakët marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

4.6. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Shoqërisë. Për këtë gëzon të drejtën që të caktojë një person të emëruar prej tij që të marrë informacion.

Neni 5
Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Kreu III
KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6



A202205285008168677

6.1. Kapitali themeltar është 100 (njëqind) Lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë e cila do të ketë vlerë nominale 100 (njëqind) Lekë dhe është nënshkruar tërësisht nga ortaku i shoqërisë.

6.2. Ndarja e pjesëve në kapitalin themeltar është:

Z. Mirsad ZYMERI, 1 (një) kuotë me pjesëmarrje në përqindje në masën 100% të kapitalit me vlerën 100 lek.

6.3. Transferimi i pjesëve të kapitalit të shoqërisë do të bëhet në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë.

Kreu IV ORGANET E SHOQËRISË

Neni 7

7.1. Organet e shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori.

7.2. Vendimet në shoqëri merren nga Asambleja e Përgjithshme. Këto vendime shënohen në Librin e Mbledhjeve të Shoqërisë që shërben edhe si Regjistër i Vendimeve të Asamblesë.

7.3. Administratori i Shoqërisë dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar caktohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1. Administrimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti.

8.2. Administrator i shoqërisë do të jetë . **Mirsad ZYMERI**, shtetas i Kosovës, i biri i Shefqet dhe i Drita, lindur me 08 Gusht 1984, në Bakshi, Kosovë dhe banues në Prishtinë, Kosovë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr. P02118466 dhe Nr. Personal 1500995226, i cili do të qëndrojë në detyrë për një afat prej 5 (pesë) vjet me të drejtë riemërimi..

DISPOZITA TË TJERA



A202205285008168677

Neni 9

9.1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore, i mbetet Ortakëve në raport me pjesët e kapitalit që zotërojnë.

9.2. Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të nënshkruesit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi i gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20 Dhjetor 2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10 Mars 2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Akti i Themelimit pasi u gjet në konformitet me ligjin dhe ju lexua me zë të lartë të përfaqësuarit dhe u deklarua prej tij se ka ndërgjegjësimin e veprimeve që i ngarkon përfaqësuesve, firmoset rregullisht para meje Noteres.

ORTAKU

I

Shoqërisë Tregtare " GREAT VIEW HOSPITALITY" sh.p.k.

Mirsad ZYMERI

MIRSAD ZYMERI

NOTERE

Sofika K. BRAKA

Taksa e Pultës
u Pagua